

# RAPORT

MONITORIMI I BUXHETIT TË  
SHQIPËRISË PËR SHËNDETËSINË:

o Janar-Gusht 2021

Të gjitha të drejtat në këtë dokument, përfshirë të drejtat e autorit, janë në pronësi të Fondacionit Westminster për Demokraci (WFD) dhe mbrohen nga ligjet e zbatueshme të Mbretërisë së Bashkuar dhe ato ndërkombëtare. Ky dokument nuk mund të kopjohet, ndahet, përkthehet në një gjuhë tjetër, apo të përshtatet pa leje paraprake nga WFD.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara

Informacioni dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë ato të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionin zyrtar të WFD-së, financuesve të saj apo Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar. As WFD dhe as ndonjë person që vepron në emër të saj, nuk mund të mbahet përgjegjës për përdorimin që mund t'i jetë bërë informacionit që ai përmban.

**Janar 2022**

## Tabela e përmbajtjes

Shkurtime .....	4
Lista e grafikëve .....	5
Hyrje .....	7
Gjetjet kryesore .....	8
1. Përmbledhje ekzekutive .....	11
2. Realizimi i buxhetit total dhe programeve të MSHMS .....	14
3. Zbatimi i programeve sipas zërave, janar - gusht 2021 .....	21
<i>I. Planifikim, Menaxhim, Administrimi</i> .....	21
<i>II. Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor</i> .....	21
<i>III. Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor</i> .....	25
<i>IV. Shërbime të Shëndetit Publik</i> .....	28
<i>V. Shërbimi Kombëtar i Urgjencës Mjekësore</i> .....	30
<i>VI. Përkujdesi Social</i> .....	31
<i>VII. Rehabilitimi i të përndjekurve politike</i> .....	32
4. Zbatimi i programeve, sipas zërave 4 mujori i dytë 2021 .....	33
5. Vdekshmëria shtesë për 9 mujorin .....	39
6. Ecuria e procesit të vaksinimit .....	42
7. Ndikimi i Covid-19 në depistimin dhe trajtimin e sëmundjeve në sistemin publik spitalor .....	42
8. Rritja e barrës së sëmundshmërisë .....	44
9. Rishikimi i buxhetit të shëndetësisë .....	45
10. Ndihmat e huaja për pandeminë .....	46
11. Konkluzione .....	48
12. Rekomandime .....	49
Referenca .....	50

## Shkurtime

PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
FSDKSH	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor
VKM	Vendime të Këshillit të Ministrave
QSUNT	Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”
ISHP	Instituti i Shëndetit Publik
QKUM	Qendra Kombëtare Urgjencës Mjekësore
QKMZHF	Qendra Kombëtare e Mirërritjes dhe Zhvillimit të Fëmijëve
MEF	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
4MI	4 majori i parë
4MII	4 majori i dytë
WFD	Fondacioni Westminster për Demokraci (Westminster Foundation for Democracy)

## Lista e grafikëve

- Grafiku 1: Rritja reale vjetore e PBB-së sipas tremujorëve (%)
- Grafiku 2: Treguesit fiskalë të konsoliduar të buxhetit të shtetit, 11 mujori
- Grafiku 3: Ecuria e realizimit të shpenzimeve të buxhetit për 8-mujorin për shëndetësinë, sipas programeve 2019-2021
- Grafiku 4: Realizimi i shpenzimeve të buxhetit për 8 mujorin për shëndetësinë sipas programeve 2020
- Grafiku 5: Realizimi i shpenzimeve të buxhetit për 8 mujorin për shëndetësinë, sipas programeve 2021
- Grafiku 6: Shpenzimet për shëndetësinë/totalit shpenzimeve buxhetore, 8 mujori (%)
- Grafiku 7: Realizimi i shërbimeve shëndetësore sipas zërave kryesore, 8 mujori
- Grafiku 8: Numri i vizitave në Kujdesin Shëndetësor Parësor
- Grafiku 9: Zbatimi i programit “Shërbime të kujdesit shëndetësor parësor” sipas zërave kryesor- 8 mujori
- Grafiku 10: Zbatimi i programit “Shërbime të kujdesit shëndetësor dytësor” sipas zërave kryesorë 8 mujori
- Grafiku 11: Zbatim i programit “Shërbime të shëndetit publik” sipas zërave, 8 mujori
- Grafiku 12: Zbatimi i buxhetit të Ministrisë së Shëndetësisë sipas programeve, 4 mujori II
- Grafiku 13: Zbatimi i buxhetit të shëndetësisë, 4 mujori II, 2020
- Grafiku 14: Zbatimi i buxhetit të shëndetësisë, 4 mujori II, 2021
- Grafiku 15: Zbatimi i buxhetit të Ministrisë së Shëndetësisë sipas zërave kryesorë 4 mujori II
- Grafiku 16: Vdekjet, 9 mujori (nr.)
- Grafiku 17: Vdekjet sipas tremujorëve
- Grafiku 18: Rritja e vdekshmërisë, janar-shtator 2021 kundrejt mesatares së janar-shtator 2018-2019 (%)
- Grafiku 19: Numri i vizitave në qendrat shëndetësore, ambulanca dhe poliklinika
- Grafiku 20: Të sëmurë të operuar gjithsej (nr.)

## Lista e tabelave

Tabela 1: Realizimi i shpenzimeve buxhetore për 8-mujorin për shëndetësinë, sipas programeve (mln lekë)

Tabela 2: Zbatimi i programit, “Planifikimi, menaxhimi, administrimi, 8 muaj” (millionë lekë)

Tabela 3: Realizimi i programit "Shërbimet e Kujdesit Parësor Shëndetësor" 8 mujori, (mln lekë)

Tabela 4: Zbatimi i programit "Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor", 8 mujori (mln lekë)

Tabela 5: Zbatimi i programit “Shërbime të Shëndetit Publik”, sipas zërave, 8 mujori (mln lekë)

Tabela 6: Zbatimi i programit "Shërbimi Kombëtar i Urgjencës Mjekësore", 8 mujori (mln lekë)

Tabela 7: Zbatimi i programit të “Përkujdesit Social”, sipas zërave, 8 mujori (mln lekë)

Tabela 8: Zbatimi i programit të rehabilitimit të ish të përndjekurve politikë, sipas zërave, 8 mujori (mln lekë)

Tabela 9: Donacionet e huaja për pandeminë në Lekë/EUR

## Hyrje

Ky raport është vazhdimësi e raportit “Monitorimi i buxhetit të Shqipërisë për Shëndetësinë, Janar – Prill 2021<sup>1</sup>”, mbështetur nga zyra e WFD dhe përgatitur nga shoqata Together for Life në shtator 2021.

Në këtë raport janë përfshirë në analizë edhe të dhënat për 4-mujorin e dytë të vitit 2021 (maj-gusht)<sup>2</sup>, duke ofruar një panoramë më të plotë të zhvillimeve përkatëse, për 8 muaj të vitit 2021 (janar-gusht). Raporti analizon të dhënat zyrtare të përdorura nga Ministria e Financave për buxhetin faktik 2021, raportet e monitorimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dhe të statistika të tjera të publikuara nga INSTAT, lidhur me vdekjet gjatë periudhës së pandemisë.

Të dhënat e raporteve të monitorimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale publikohen në bazë 4 mujore, ndërsa të dhënat e tjera për ecurinë e treguesve ekonomikë dhe statistikat e vdekshmërisë publikohen nga institucionet përkatëse me bazë tremujore, ose mujore. Për këtë arsye, të dhënat për monitorimin e shpenzimeve të shëndetësisë do të raportohen për periudhën 8 mujore (janar-gusht 2021), ndërsa të dhënat e tjera për periudhën 9 mujore (janar-shtator 2021).

Gjithashtu janë shfrytëzuar të dhënat e prokurimeve në sektorin e shëndetësisë nga [openprocurement.al](http://openprocurement.al). Krahas analizimit të të dhënave që janë publike, u dërguan kërkesa për informacion bazuar në ligji “Për Informimin Publik” në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Drafti i raportit është ndarë për konsultim edhe me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

---

<sup>1</sup> <https://www.wfd.org/what-we-do/resources/monitoring-state-budget-health-albania>

<sup>2</sup> Raporti do të plotësohet me të dhëna për realizimin e shpenzimeve për 12-muaj për sektorin e shëndetësisë, sapo të dhënat të bëhen publike nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

## Gjetjet kryesore

Shpenzimet për sektorin e shëndetësisë shënuan rritje të ndjeshme në 8 mujorin 2021, ndryshe nga viti 2020<sup>3</sup>, kur pandemia nuk ushtroi presion të lartë mbi fondet publike, së paku në aspektin e fondeve shtesë që duhen për përballimin e krizës shëndetësore.

Për periudhën janar- gusht 2021, shpenzimet totale faktike për shëndetësinë ishin 49 miliardë lekë (402 milionë Euro), me një rritje prej 14.7% me bazë vjetore në krahasim me periudhën përkatëse 2020, ose 6.3 miliardë lekë (52 milionë Euro) më shumë.

Në krahasim me 8 mujorin 2019, kur vendi ishte në një periudhë normale shëndetësore, shpenzimet për shëndetësinë janë rritur ndjeshëm me 25.5%, të ndikuara nga programet e “Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Dytësor”, “Shërbimeve të Shëndetit Publik” dhe “Përkujdesit Social”.

Rritja e shpenzimeve të shëndetësisë përgjatë 8 mujorit janar- gusht 2021 është ndikuar kryesisht nga situata pandemike, që ka ushtruar presion tek fondet për trajtimin e pacientëve të shtruar në spitale dhe shpenzimet për vaksinimin e popullatës.

Fondi për “Trajtimin e pacienteve të shtruar në spitale”, u rrit me 34%, ose 3.7 miliardë lekë (30 milionë Euro) më shumë, për 8 mujorin 2021, në raport me periudhën përkatëse 2020.

“Persona të vaksinuar me vaksinën anti COVID-19”, është një zë i ri që u zbatua për herë të parë në vitin 2021, në kuadër të programit për vaksinimin kundër COVID-19, me një fond total për 8 mujorin prej 2.8 miliardë lekë (22.7 milionë Euro).

Programi “Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor” zuri për herë të parë pjesën më të madhe të shpenzimeve të shëndetësisë, me 38.3% të totalit për 8 mujorin e vitit 2021, e ndikuar nga shtimi i shpenzimeve për trajtimin e pacientëve në spitale.

Në 4 mujorin e dytë të 2021, shpenzimet totale faktike për shëndetësinë ishin 25 miliardë lekë (203 milionë Euro), me një rritje prej 16% me bazë vjetore, ose 3.5 miliardë lekë (28 milionë Euro) më shumë.

Shpenzimet për “Trajtimin e pacienteve të shtruar në spitale” dhe “Numri i vizitave në Kujdesin Shëndetësor Parësor”, u rritën me ritme më të ngadalta në 4 mujorin e dytë,

---

<sup>3</sup> Në 2020, kur pandemia ra në vend me dy valë të njëpasnjëshme, gusht dhe nëntor- dhjetor, sektori i shëndetësisë harxhoi vetëm 7.2% të shpenzimeve totale buxhetore me rënie prej 0.2 pikë përqindje në raport me vitin 2019, referuar raportit të Monitorimit për vitin 2020 dhe 4 mujorin e parë 2021 <https://www.wfd.org/what-we-do/resources/monitoring-state-budget-health-albania>

në raport më të parin, duke reflektuar lehtësimin e pandemisë në raport me muajt e parë të vitit.

Në katër mujorin e dytë të vitit u shënuan rritje të ndjeshme të shpenzimeve për zërat “Pacientë të trajtuar nga paketat e kardiologjisë dhe kardiokirurgjisë” (+40%) dhe “Pacientë të trajtuar me dializë” (+71), një tregues indirekt se pandemia po shkakton rritjen e barrës së sëmundjeve të tjera.

Pavarësisht rritjes së detyruar të shpenzimeve për shëndetësinë përgjatë 8 mujorit, buxheti i rishikuar me Akt Normativ më 22 qershor 2021, shkurtoi me 1.4% fondet totale për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të cilat u ulën në 70.4 miliardë lekë (572 milionë Euro) nga 71.4 miliardë lekë (580.5 milionë Euro), që ishin në buxhetin fillestar. Sipas programeve kryesore, shërbimet e kujdesit parësor u shkurtuan me 12.7% dhe shërbimet e shëndetit publik ranë me 1.5%.

Vdekshmëria shtesë vijoi të ishte e lartë në 9 mujorin janar-shtator të vitit 2021, e ndikuar nga shtimi i ndjeshëm i fataliteteve në periudhën janar-mars. Për periudhën janar-shtator 2021, në vend u regjistruan 21,471 vdekje me një rritje prej 17.9% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2020, kur vendi u përball me valën e parë të pandemisë. Në raport me mesataren 2016-2019, periudhë që merret si referencë për krahasimin e vdekshmërisë shtesë të shkaktuar nga pandemia, rritja arrin në 34%.

Pavarësisht përshpejtimit të procesit, Shqipëria mbetet ndër të fundit në Evropë sa i përket vaksinimit, në raport me popullatën. Deri në 30 shtator, Shqipëria kishte kryer 1,732,549 vaksinime<sup>4</sup>. Prej tyre 788,538 qytetarë i kishin kryer të dy dozat e vaksinës anti-COVID. E vaksinuar me të paktën me një dozë ishte rreth i 33% e popullsisë.

Pasojat direkte të pandemisë në shëndetin e personave që e kanë kaluar atë, si dhe vonesat në trajtimin e diagnostikimit të sëmundjeve të tjera për shkak të karantinës, kanë ndikuar në rritjen e barrës së sëmundshmërisë në vend për 9 mujorin 2021. Numri i vizitave në qendrat shëndetësore të kujdesit parësor u rrit me 16% në krahasim me të njëjtën periudhë të 2020-s dhe 6% në raport me janar-gusht 2019.

Për periudhën janar-gusht 2021 në spitalet psikiatrike numri i pacientëve të shtruar është rritur 10,5% në krahasim me vitin e kaluar.<sup>5</sup>

Pasojat post COVID -19, priten të ushtrojnë presion për shpenzime më të larta në shëndetësi. Të dhëna operative nga Instituti i Shëndetit Publik tregojnë se rreth 20 mijë persona po vuajnë “COVID-in e gjatë”. Ata po vuajnë nga pasojat direkte dhe indirekte të sëmundjes, të tilla si dëmtime të mushkërive, lodhje kronike dhe dëmtim të sistemit

---

<sup>4</sup> <https://shendetesia.gov.al/vaksinimi-anticovid-kryhen-1732549-vaksinime/>

<sup>5</sup> <https://www.monitor.al/covid-19-rriti-rastet-me-ankth-dhe-depresion-10-me-shume-shtrime-ne-psikiatri/>


nervor dhe çrregullime psikike. Një tjetër problem i konstatuar nga raportet e deritanishme është mungesa e të dhënave, sidomos e atyre të lidhura me pasojat direkte dhe indirekte të pandemisë në shëndetin e popullatës.

## 1. Përmbledhje ekzekutive

Për të dytin vit radhazi, në 2021-in Shqipëria menaxhoi pandeminë e COVID-19, që ka shkaktuar pasoja të rënda në ekonomi dhe sidomos në humbjen e jetëve njerëzore.

Ndryshe nga viti 2020, kur pasojat e pandemisë ishin shumë të forta në ekonomi, - duke shënuar një rënie prej 4% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB), më e forta që nga viti 1997, në 2021-n ekonomia shfaqti shenja të forta rigjallërimi. Për 3 mujorin e parë të 2021, PBB u rrit me 5.51% në krahasim me të njëjtën periudhë të 2020-s, pas një rënieje me 3.53% në janar-mars 2020<sup>6</sup>. Në 3 mujorin e dytë rritja u përshpejtua në 17.8%, pas një rënieje prej 11.33%, në të njëjtën periudhë të një viti më parë, kur vendi vuajti pasojat e karantinës. Rritja vijoi dhe në 3 mujorin e tretë me 7%.

**Grafiku 1: Rritja reale vjetore e PBB-së, sipas tremujorëve (%)**



*Burimi: INSTAT*

Ecuria e mirë në 9 mujorin ka bërë që qeveria shqiptare dhe institucionet ndërkombëtare të rrisin parashikimin për performancën e vitit 2021 në rreth 8%<sup>7</sup>.

Në vijim të ecurisë së mirë të ekonomisë, të ardhurat buxhetore kanë shënuar gjithashtu rritje të ndjeshme. Për 9 mujorin 2021, të ardhurat në buxhet arritën në 368 miliardë lekë (3 miliardë Euro)<sup>8</sup>, me një rritje prej 19.3% në krahasim me të njëjtën periudhë të


<sup>6</sup> <http://instat.gov.al/al/temat/ekonomi-dhe-financ%C3%AB/llogarit%C3%AB-komb%C3%ABtare-gdp/#tab2>

<sup>7</sup> <https://www.imf.org/en/News/Articles/2021/10/12/mcs101221-albania-2021-article-iv-consultation-concluding-statement>

<sup>8</sup> <http://financa.gov.al/statistika-fiskale-mujore/>

një viti më parë dhe 7.7% më shumë se periudha para-pandemis e janar-nëntor 2019, një sinjal se ekonomia i ka tejkaluar nivelet e para-krizës.

**Grafiku 2: Treguesit fiskalë të konsoliduar të buxhetit të shtetit, 9 mujori**



*Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë*

Ndërsa ekonomia u rikuperua me shpejtësi në vitin 2021, situata shëndetësore vijoi të ishte e rënduar, me një vdekshmëri të lartë shtesë<sup>9</sup>, sidomos në pjesën e parë të vitit. Vala e dytë e pandemisë, që kulmoi në janar-mars 2021, shënoi rritje të lartë të fataliteteve në vend. Në 3 mujorin e parë të vitit, u raportuan 9,657 humbje jete

<sup>9</sup> Vdekshmëria shtesë (excess death/mortality) është një term i përdorur në epidemiologji dhe shëndetin publik që i referohet numrit të vdekjeve nga të gjitha shkaqet gjatë një periudhe krize që është mbi dhe përtej asaj që do të pritej në kushte normale <https://ourworldindata.org/excess-mortality-COVID>

gjithsej<sup>10</sup>, me një rritje prej 52.4% në raport me mesataren e 2016-2019 për të njëjtën periudhë.

Për periudhën janar-shtator 2021, në vend u regjistruan në total 21,471 vdekje me një rritje prej 17.9% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2020, kur vendi u përball me valën e parë të pandemisë.

Në raport me mesataren 2016 -2019, periudhë që merret si referencë për krahasimin e vdekshmërisë shtesë të shkaktuar nga pandemia, rritja arrin në 34%. Qeveria shqiptare, ndryshe nga shumë shtete të Evropës, nuk ndërmori më masa shtrënguese për të kufizuar përhapjen e virusit, çka shtoi dhe rritjen e ngarkesës në spitale në muajt e parë të vitit.

Nga marsi 2020 deri në shtator 2021, vdekshmëria në vend është rritur me rreth 35% në krahasim me periudhën përkatëse të mesatares 2018-2019. Sipas të dhënave të Eurostat<sup>11</sup> dhe statistikave rajonale, Shqipëria është e treta në Evropë për rritjen më të lartë të vdekshmërisë shtesë, pas Kosovës (43.4) dhe Maqedonisë së Veriut (42.6), shumë më e lartë sesa mesatarja në shtetet e tjera të Evropës, që varion midis 2-22% për periudhën e sipërpërmendur.

Ndryshe nga viti 2020, kur pandemia nuk ushtroi presion të lartë mbi fondet publike, së paku në aspektin e fondeve shtesë që duhen për përballimin e krizës shëndetësore, për 8 mujorin 2021 shpenzimet për sektorin e shëndetësisë shënuan rritje të ndjeshme.

Për periudhën janar- gusht 2021, shpenzimet totale faktike për shëndetësinë ishin 49 miliardë lekë<sup>12</sup> (402 milionë Euro), me një rritje prej 14.7% me bazë vjetore<sup>13</sup>, ose 6.3 miliardë lekë (52 milionë Euro) më shumë.

Rritja e shpenzimeve për shëndetësinë u ndikua nga njëra anë nga performanca e mirë e të ardhurave buxhetore, si rrjedhojë e rikuperimit të ekonomisë dhe nga ana tjetër ishte e detyruar nga situata emergjente për shkak të nevojës për të vaksinuar popullatën dhe përballimin e shpenzimeve për trajtimin e të shtruarve në spitale.

Pasojat direkte të pandemisë në shëndetin e personave që e kanë kaluar atë, si dhe vonesat në trajtimin e diagnostikimit dhe sëmundjeve të tjera për shkak të karantinës, kanë ndikuar në rritjen e barrës së sëmundshmërisë në vend për 9 mujorin 2021.

---

<sup>10</sup> <http://instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/lindjet-vdekjet-dhe-martetasat/publikimet/2021/treguesit-demografik%C3%AB-t3-2021/>

<sup>11</sup> [https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/demo\\_r\\_mwk\\_ts/default/table?lang=en](https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/demo_r_mwk_ts/default/table?lang=en)

<sup>12</sup> Shifra i referohet totalit të shpenzimeve faktike të deklaruara nga Ministria e Shëndetësisë në raportet 4 mujore të monitorimit dhe nuk përfshin të dhënat për rimbursimet e barnave, që raportohen veçmas nga FDSKSH

<sup>13</sup> <https://shendetesia.gov.al/tabelat-e-raportimit-per-intervalet-kohore-3-muaj-9-muaj-dhe-vjetore-si-dhe-relacionet-perkatese/>

Numri i vizitave në qendrat shëndetësore të kujdesit parësor u rrit me 16% në krahasim me të njëjtën periudhë të 2020-s dhe 6% në raport me janar-gusht 2019.

Në katër mujorin e dytë të vitit u shënuan rritje të ndjeshme të shpenzimeve për zërat “Pacientë të trajtuar nga paketat e kardiologjisë dhe kardiokirurgjisë” (+40%) dhe “Pacientë të trajtuar me dializë” (+71), një tregues indirekt se pandemia po shkakton rritjen e barrës së sëmundjeve të tjera.

## 2. Realizimi i buxhetit total dhe programeve të MSHMS

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) administron dhe menaxhon fondet publike sipas shtatë programeve të miratuara, si vijon:

1. Planifikim, Menaxhim, Administrimi
2. Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor
3. Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor
4. Shërbime të Shëndetit Publik
5. Shërbimi Kombëtar i Urgjencës Mjekësore
6. Përkujdesi Social
7. Rehabilitimi i të Përndjekurve Politikë

Për periudhën janar- gusht 2021, shpenzimet totale faktike për shëndetësinë ishin 49 miliardë lekë<sup>14</sup> (402 milionë Euro), me një rritje prej 14.7% me bazë vjetore<sup>15</sup>, ose 6.3 miliardë lekë (52 milionë Euro) më shumë.

Ndryshe nga viti 2020, kur rritja u udhëhoq nga shtimi i shpenzimeve të programeve për “Përkujdesin Social” dhe “Planifikim, Menaxhim Administrim”, përgjatë tetë muajve të 2021-it, zgjerimi është orientuar nga programet:

“Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor” dhe “Shërbime të Shëndetit Publik”, që shtuan përkatësisht me 3.87 miliardë lekë (31.7 milionë Euro) dhe 3.35 miliardë lekë (27.5 milionë Euro).

---

<sup>14</sup> Shifra i referohet totalit të shpenzimeve faktike të deklaruara nga Ministria e Shëndetësisë në raportet 4 mujore të monitorimit dhe nuk përfshin të dhënat për rimbursimet e barnave, që raportohen veçmas nga FDSKSH.


<sup>15</sup> <https://shendetesia.gov.al/tabelat-e-raportimit-per-intervalet-kohore-3-muaj-9-muaj-dhe-vjetore-si-dhe-relacionet-perkatese/>

**Tabela 1: Realizimi i shpenzimeve të buxhetit për 8-mujorin për shëndetësinë, sipas programeve (mln lekë)**

Emri i Programit	2019	2020	2021	Ndryshimi në vlerë 2021/2020	Ndryshim i në % 2021/2020
Planifikim Menaxhim Administrim	197	1,107	270	-836	-75.6
Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor	5,397	5,546	5,891	344	6.2
Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor	15,375	14,950	18,820	3,870	25.9
Shërbime të Shëndetit Publik	1,651	1,706	5,063	3,357	196.8
Shërbimi Kombëtar i Urgjencës Mjekësore	89	115	142	27	23.5
Përkujdesi Social	15,743	18,621	18,400	-222	-1.2
Rehabilitimi i të përndjekurve politike	977	710	488	-222	-31.2
<b>Totali i shpenzimeve</b>	<b>39,429</b>	<b>42,755</b>	<b>49,073</b>	<b>6,319</b>	<b>14.8</b>
<i>Burimi: Raportet e monitorimit, Ministria e Shëndetësisë, 8 muji, 2019-2021</i>					

Në krahasim me 8 mujorin 2019, kur vendi ishte në një periudhë normale shëndetësore, shpenzimet për shëndetësinë janë rritur ndjeshëm me 25.5%, të ndikuara nga programet e “Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor”, “Shërbime të Shëndetit Publik” dhe “Përkujdesi Social”.

**Grafiku 3: Ecuria e realizimit të shpenzimeve të buxhetit për 8-mujorin për shëndetësinë, sipas programeve 2019-2021**




*Burimi: Raportet e monitorimit, Ministria e Shëndetësisë, 8 mujori, 2019-2021*

“Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor” zunë për herë të parë pjesën më të madhe të shpenzimeve të shëndetësisë, me 38.3% të totalit për 8 mujorin e vitit 2021. Në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ka një rritje me 3.4%, e ndikuar nga shtimi i shpenzimeve për trajtimin e pacientëve në spitale. Programi i dytë është “Përkujdesi Social”, me 37.5% të totalit, i ndjekur nga “Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor” (12%).


Në dy grafikët më poshtë jepet krahasimi i peshës që zënë programet përkatëse në totalin e shpenzimeve buxhetore të MSHMS-së për periudhën e 8 mujorit për vitet 2020 dhe 2021.

**Grafiku 4: Realizimi i shpenzimeve të buxhetit për 8 mujorin për shëndetësinë sipas programeve 2020**



*Burimi: Raportet e monitorimit, Ministria e Shëndetësisë, 8 muji 2020*


**Grafiku 5: Realizimi i shpenzimeve të buxhetit për 8 mujorin për shëndetësinë, sipas programeve 2021**



*Burimi: Raportet e monitorimit, Ministria e Shëndetësisë, 8 mujori 2021*

Shpenzimet për shëndetësinë janë rritur dhe në raport me totalin e shpenzimeve të buxhetit për 8 mujorin, duke arritur në 13.8% të totalit në janar-shtator 2021, nga 12.7% në 2019-n dhe 13.2% në 2020-n.

**Grafiku 6: Shpenzimet për shëndetësinë/totalit shpenzimeve buxhetore për periudhën 2019-2021, 8 mujori (%)**



*Burimi: Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave, përpunime të autorëve*


Duke përfshirë dy programe, “Përkujdesi Social” dhe “Rehabilitimi i të Përndjekurve Politike”, që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me shërbimet shëndetësore, buxheti i shëndetësisë për 8 mujorin ishte 30.2 miliardë lekë (247 milionë Euro), duke u rritur me 29% në krahasim me të njëjtën periudhë të 2020-s dhe 33% në krahasim me 8 mujorin 2019.

Sipas zërave kryesorë të detajuar nga pesë programet direkte të shëndetësisë, “Planifikim, Menaxhim, Administrim”, “Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor”, “Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor”, “Shërbime të Shëndetit Publik” dhe “Shërbimi Kombëtar i Urgjencës Mjekësore” rritja e shpenzimeve të shëndetësisë në 8 mujorin 2021 është ndikuar nga:

- “Trajtimi i pacientëve të shtruar në spitale”, fondi për të cilin u rrit me 34%, ose 3.7 miliardë lekë (30 milionë Euro) më shumë.
- “Persona të vaksinuar me vaksinën anti COVID-19”, është një zë i ri që u zbatua për herë të parë në vitin 2021, në kuadër të programit për vaksinimin kundër COVID-19, me një fond total për 8 mujorin prej 2.8 miliardë lekë (22.7 milionë Euro).

- “Numri i vizitave në Kujdesin Shëndetësor Parësor”, me një rritje prej 88% për 8 mujorin në krahasim me janar-gusht 2020, ose 1.1 miliardë lekë (9 milionë Euro) më shumë.
- “Monitorimi i situatave epidemiologjike”, me një rritje prej 20% me bazë vjetore për 8 mujorin, ose 260 milionë lekë (2.1 milionë Euro) më shumë.

### Grafiku 7: Realizimi i shërbimeve shëndetësore sipas zërave kryesore, 8 mujori



Burimi: Raportet e monitorimit, Ministria e Shëndetësisë, 8 mujori, 2019-2021

### 3. Zbatimi i programeve sipas zërave, janar - gusht 2021

#### I. PLANIFIKIM, MENAXHIM, ADMINISTRIMI

Ky program përfshin kryesisht shpenzimet për aktet ligjore e nënligjore të miratuara. Në dy vitet e fundit në këtë program janë shtuar edhe zërat për blerjen e materialeve mbrojtëse për COVID-19 dhe bonuset për mjekët dhe infermierët jashtë shtetit, në kuadër të COVID-19.

Shpenzimet për këtë program ishin 270 milionë lekë (2.2 milionë Euro) për janar-gusht 2021, me një tkurrje prej 75% në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Rënia ka ardhur pasi nuk u zbatuan shpenzime për materialet mbrojtëse kundër COVID-19.

**Tabela 2: Realizimi i programit, "Planifikimi, menaxhim, administrim, 8 mujori" (mln lekë)**

Planifikimi, menaxhim, administrim, 8 mujori në 3 vjet (mln lekë)	2019	2020	2021	Ndryshimi në %, 2021/2020
Akte ligjore e nënligjore të miratuara	195	234	269	15.1
Materiale mbrojtëse të blera për COVID-19	0	667	0	-100
Blerje pajisje mjekësore	0	74	0	-100
Pajisje mobilimi, teknologjike dhe kompjuterike	0	88	0	-100
Projekte të mbështetura me kosto lokale dhe TVSH	2	44	1	-100
<b>TOTALI</b>	<b>197</b>	<b>1,107</b>	<b>270</b>	<b>-75.6</b>

*Burimi: Raportet e monitorimit, Ministria e Shëndetësisë, 8 mujori, 2019-2021*

#### II. SHËRBIME TË KUJDESIT SHËNDETËSOR PARËSOR

Programi i "Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor" ka si objektiv kryesor përmirësimin e shërbimeve parandaluese dhe të diagnostikimit të hershëm të sëmundjeve si dhe plotësimin e qendrave shëndetësore në masën 80% me infrastrukturën e nevojshme për funksionimin e sistemit të informacionit.

Shpenzimet për këtë program ishin 5.9 miliardë lekë (48 milionë Euro) për janar-gusht 2021, me një rritje prej 6.1% në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

**Tabela 3: Realizimi i programit "Shërbime të kujdesit Shëndetësor parësor" 8 mujori, (mln lekë)**


<b>Realizimi i programit Shërbime të kujdesit Shëndetësor parësor, 8 mujori, (mln lekë)</b>	<b>2019</b>	<b>2020</b>	<b>2021</b>	<b>Ndryshimi në %, 2021/2020</b>
Numri i vizitave në Kujdesin Shëndetësor Parësor (kosto)	1,527	1,243	2,340	88.2
Persona që përfitojnë check - up	433	352	0	-
Pacientë të trajtuar me recetë me rimbursim nga mjeku i familjes	3,160	3,878	3,400	-12.3
Blerje pajisje mjekësore Tiranë- Korçë (Kooperacioni Italian)	40	-	-	-
Rikonstruksione të qendrave shëndetësore dhe ambulancave	21	35	133	276.0
Ndërtim i q.sh dhe amb. nga Gjysmë Hëna e Kuqe dhe Kooperacioni Zviceran	198	0	2	867.9
Ndërtime/rikonstruksione të ambienteve të DSHP	17	-	13	-
Blerje pajisje mjekësore për shërbimin parësor	40	-	2	-
Të tjera	-	37	-	-
<b>TOTALI</b>	<b>5,437</b>	<b>5,546</b>	<b>5,891</b>	<b>6.2</b>
<i>Burimi: Raportet e monitorimit, Ministria e Shëndetësisë, 8 mujori, 2019-2021</i>				

Rritja është ndikuar tërësisht nga dyfishimi i buxhetit për zërin e “Numri i vizitave në Kujdesin Shëndetësor Parësor”, që u rrit me 88.2%, duke arritur në 2.3 miliardë lekë (19 milionë Euro). Në raportin e monitorimit të Ministrisë së Shëndetësisë së 8 mujorit 2021 theksohet se “Personeli i qendrave shëndetësore, është angazhuar maksimalisht për

ofrimin e shërbimit ndaj popullatës edhe në kushtet e vështira të shkaktuara nga pandemia, nëpërmjet konsultave e vizitave, në qendra e në distancë”.

Gjatë 8 mujorit të vitit 2021, në qendrat shëndetësore të kujdesit parësor të financuara nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH) janë realizuar 4,574,257 vizita. Në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë, numri i vizitave është rritur me 16%. Kjo rritje reflekton si efektin e numrit më të ulët të vizitave në janar-gusht 2020 (që ishin 9% më të ulëta se 8 mujorin 2019 për shkak të pandemisë, kur shumë persona me sëmundje të tjera hezituan të shkonin në spitale), po ashtu dhe shtimin e problematikave të popullata, që e ka kaluar COVID-19 dhe po vuan pasojat afatgjata të virusit. Në një tregues indirekt të rritjes së barrës së sëmundshmërisë në vend, numri i vizitave në Kujdesin Shëndetësor Parësor për 8 mujorin 2021 ishte 6% më i lartë se në të njëjtën periudhë të vitit normal 2019.

### Grafiku 8: Numri i vizitave në Kujdesin Shëndetësor Parësor




*Burimi: Raportet e monitorimit, Ministria e Shëndetësisë, 8 mujori, 2019-2021*

Shpenzimet për pacientë të trajtuar me recetë me rimbursim nga mjeku i familjes zënë peshën kryesore të programit të Kujdesit Shëndetësor Parësor, me 58% të totalit. Ky zë shënoi një rënie prej 12.3%, duke arritur në 3.4 miliardë lekë (27.6 milionë Euro). Sipas raportit të Monitorimit të 8 mujorit 2021 janë trajtuar me barna të rimbursuara, gjatë 8-mujorit 2021, mbi 343 mijë pacientë (pothuaj sa një vit më parë), 60% e të cilëve i takojnë kategorisë të pensionistëve, mbi 21% të sëmurë kronikë dhe mbi 10% invalidë.

Shpenzimet për persona që përfitojnë check – up ishin zero, për shkak të ndërprerjes së këtij shërbimi gjatë pandemisë. Sipas raportit të monitorimit të 8 mujorit 2021 të MSHMS-së, “duke filluar nga gjysma e dytë e muajit mars 2020 ky shërbim është ndërprerë përkohësisht, për shkak të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19. Buxheti vjetor është pakësuar me 450 milionë lekë. Gjatë periudhës në funksionim, janë realizuar 100,243 check up, ndërkohë që janë likuiduar detyrimet për periudhën nëntor-dhjetor 2019, si dhe likuidohen në vazhdimësi detyrimet e krijuara për vitin 2020, deri në ndërprerjen e shërbimit”.<sup>16</sup>

**Grafiku 9: Realizimi i programit “Shërbime të kujdesit shëndetësor parësor” sipas zërave kryesorë, 8 mujori, periudha 2019-2021**



*Burimi: Raportet e monitorimit, Ministria e Shëndetësisë, 8 mujori, 2019-2021*

<sup>16</sup> <https://shendetesia.gov.al/tabelat-e-raportimit-per-intervalet-kohore-3-muaj-9-muaj-dhe-vjetore-si-dhe-relacionet-perkatese/>

### III. SHËRBIME TË KUJDESIT SHËNDETËSOR DYTËSOR

Programi i "Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Dytësor" synon ofrimin gjithëpërfshirës të shërbimeve të kujdesit shëndetësor dytësor si dhe trajtimin e pacientëve për përballimin e situatës së krijuar nga pandemia si dhe trajtimin stimulues të personelit shëndetësor në vijën e parë në luftën ndaj pandemisë COVID-19.

Shpenzimet për shërbimet e kujdesit shëndetësor dytësor u rritën me 26% me bazë vjetore në janar-gusht 2021, duke arritur në 18.8 miliardë lekë (153 milionë Euro).

Ndikimin kryesor në këtë rritje e dha zëri "Trajtimi i pacientëve të shtruar në spitale", që ka dhe peshën kryesore të këtij programi, me 77% për 8 mujorin 2021. Ky zë u rrit me 34% me bazë vjetore, duke arritur në 14.5 miliardë lekë (118 milionë Euro) në janar-gusht 2021. Sipas raportit të monitorimit të MSHMS-së së 8 mujorit 2021, me këtë fond "janë përballuar nevojat e spitaleve në paga, shpërblime për personelin në luftën e parë ndaj pandemisë (rreth 1.3 miliardë lekë), sigurime, mallra e shërbime (kërkesat shtesë për këtë artikull janë rreth 2 miliardë lekë, një pjesë e të cilave janë duke u plotësuar me burime të brendshme të FDSKSH)".

**Tabela 4: Zbatimi i programit "Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor", 8 mujori (mln lekë)**

Zbatimi i programit Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor, 8 mujori (mln lekë) në 3 vjet	2019	2020	2021	Ndryshimi në %, 2021/2020
Trajtimi i pacientëve të shtruar në spitale	12,157	10,846	14,530	34.0
Pacientë të trajtuar me dializë	1,222	1,734	1,783	2.9
Trajtimi i pacientëve në spitalet psikiatrike	428	420	466	10.8
Pacientë të trajtuar nga paketat e kardiologjisë dhe kardiokirurgjisë	197	695	637	-8.3
Pacientë të trajtuar nga paketat e transplantave renale	15	4	0	-
Pacientë të trajtuar me katarakte	12	36	42	17.1
Pacientë të trajtuar me radioterapi	18	66	120	81.7
Pacientë të trajtuar me COVID	0	115	0	-
Ekzaminime laboratorike	0	0	366	-
Pacientë të trajtuar në QKMZHF	0	0	37	-
Barna dhe pajisje mjekësore të regjistruara	0	0	57	


Shpenzime per akomodimin e punonjësve që do të jenë të angazhuar në ndërtimin e Spitalit "Memorial" Fier (donacion i Qeverisë Turke në kuadër të pandemisë COVID-19)	0	0	35	-
Rikonstruksioni i pediatriisë+Kukësi BB	0	105	0	-
Projekti i Bankës Botërore	46	0	0	-
Faza e dytë e reabilitimit të QSUT Kredi CEB <sup>17</sup>	614	165	279	69.2
Blerje pajisje mjekësore për shërbimin spitalor	32	80	215	168.1
Ndërtime/rikonstruksione	0	313	251	-20.0
Projekti Global fund	434	37	3	-91.6
Të tjera	199.584	334	0	-100.0
TOTALI	15,375	14,950	18,820	25.9
<i>Burimi: Raportet e monitorimit, Ministria e Shëndetësisë, 8 mujori, 2019-2021</i>				

Sipas raportit të monitorimit të MSHMS-së së 8 mujorit 2021, “Për paketat spitalore në ofrues privat të shërbimit (spitalet jopublike) u paguan 958 milionë lekë (7.8 milionë Euro), sa 83.2% e planit 8 mujor. Financimi i paketave në spitalet jopublike është realizuar nga Drejtoria e Shërbimeve Spitalore Universitare, nga Drejtoritë Rajonale Berat, Durrës, Gjirokastrë, Fier, për paketën e dializës. Detyrimet nga viti 2020 në shumën 121 milionë lekë (983 milionë Euro) u likuiduan që në muajt e parë të vitit”.

Gjatë vitit 2021, në bazë të kontratës koncensionare të ofrimit të shërbimit të laboratorëve, ky shërbim, përveçse në QSUNT është shtrirë edhe në spitalet e tjera universitare, si dhe është duke u shtrirë në spitalet rajonale. Shërbimi i realizuar 8 mujor (shifra operative) është 595.8 milionë lekë (4.8 milionë Euro), ndërsa pagesa e realizuar nga spitalet është 346 milionë lekë (2.8 milionë Euro).

<sup>17</sup> Banka për Zhvillim e Këshillit të Europës (CEB)

**Grafiku 10: Zbatimi i programit “Shërbime të kujdesit shëndetësor dytësor” sipas zërave kryesorë, 8 mujori, periudha 2019-2021**



*Burimi: Raportet e monitorimit, Ministria e Shëndetësisë, 8 mujori, 2019-2021*

#### IV. SHËRBIME TË SHËNDETIT PUBLIK

Shërbimi i shëndetit publik ofrohet nëpërmjet programeve kombëtare të imunizimit, TBC, HIV/AIDS dhe Sëmundjet Seksualisht të Transmetueshme (SST), të survejancës epidemilogjike dhe ndjekjes së sëmundshmërisë infektive (sëmundshmërisë kronike me pasoja në shëndetin publik të ndikuara nga kushtet e mjedisit) si dhe të programeve të sigurisë ushqimore, kontrollit të ujit të pijshëm dhe shëndetit riprodhues.

Shpenzimet faktike për programin e “Shërbime të Shëndetit Publik” ishin gati 5.1 miliardë lekë (41 milionë Euro) për 8 mujorin e parë 2021, duke u trefishuar në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Kjo rritje ka ardhur si rrjedhojë e shtimit në këtë program të vaksinave kundër COVID-19, që ka për qëllim imunizimin e popullatës. Shpenzimet për personat e vaksinuar me vaksinën anti COVID-19 rezultuan 2.8 miliardë lekë, duke shpenzuar 100% të buxhetit të planifikuar vjetor për këtë zë.

Shpenzimet për vaksinimin e popullatës zunë 55% të totalit të programit të “Shërbime të Shëndetit Publik” për 8 mujorin.

Gjatë periudhës janar-gusht 2021 me vaksinën anti COVID-19 janë vaksinuar me 2 doza 625,773 persona dhe me një dozë 817,602 persona, sipas raportit të Monitorimit të MSHMS-së së 8 mujorit 2021

**Tabela 5: Zbatimi i programit “Shërbime të Shëndetit Publik”, sipas zërave, 8 mujori (mln lekë)**

Zbatimi i programit Shërbime të Shëndetit Publik, sipas zërave, 8 mujori (mln lekë)	2019	2020	2021	Ndryshim i në %, 2021/2020
Fëmijë të vaksinuar 0-18 vjeç	193	159	174	8.95
Monitorimi i situatave epidemiologjike	1,299	1,276	1,536	20.42
Inspektime të kryera nga inspektoratet	155	158	231	46.31
Gra të depistuar për kancerin e gjirit	0.31	5	0.951	-82.13
Inspektime të kryera nga OKSH <sup>18</sup> në spitale NJVKSH <sup>19</sup> dhe QSH <sup>20</sup>	0	107	226	111.90


18 Operatori i Kujdesit Shëndetësor

19 Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor

20 Qendra Shëndetësore

Gra të depistuar për kancerin e qafës së mitrës	0	0.062	0	-
Personel mjekësor dhe jo mjekësor i trajtuar me bonus për COVID-19	0	0	100	-
Persona të vaksinuar me vaksinën anti COVID-19	0	0	2,794	-
Rikonstruksione të ambienteve	0.874	0.072	0	-
Pajisje kompjuterike	2	0	0	-
TOTALI	1,651	1,706	5,063	196.82
<i>Burimi: Raportet e monitorimit, Ministria e Shëndetësisë, 8 mujori, 2019-2021</i>				

**Grafiku 11: Zbatim i programit “Shërbime të shëndetit publik” sipas zërave, 8 mujori, periudha 2019-2021**



*Burimi: Raportet e monitorimit, Ministria e Shëndetësisë, 8 mujori, 2019-2021*

## V. SHËRBIMI KOMBËTAR I URGJENCËS MJEKËSORE

Ky program synon të zhvillojë shërbimin e urgjencës mjekësore si pjesë integrale të sistemit shëndetësor, të sigurojë ofrimin e ndihmës urgjente mjekësore në kohë dhe cilësi, në të gjithë vendin, si dhe të rrisë vetëdijen e popullatës mbi përparësitë e përdorimit korrekt të shërbimit të urgjencës mjekësore.

Shpenzimet faktike për këtë program ishin 142 milionë lekë (1.1 milionë Euro), me një rritje prej 25.6% për zërin raste të trajtuara nga njësitë e urgjencës mjekësore.

**Tabela 6: Zbatimi i programit "Shërbimi Kombëtar i Urgjencës Mjekësore", 8 mujori (mln lekë)**

Zbatimi i programit Shërbimi Kombëtar i Urgjencës Mjekësore, 8 mujori (mln lekë)	2019	2020	2021	Ndryshimi në %, 2021/2020
Raste të trajtuara nga njësite e urgjencës mjekësore	82	113	142	25.6
Personel mjekësor dhe jo mjekësor i trajtuar me bonus për COVID-19	0	0	0	-
Pajisje mjekësore për autoambulancat e shërbimit të urgjencës.	7	2	0	-
<b>TOTALI</b>	<b>89</b>	<b>115</b>	<b>142</b>	<b>23.5</b>
<i>Burimi: Raportet e monitorimit, Ministria e Shëndetësisë, 8 mujori, 2019-2021</i>				

## VI. PËRKUJDESI SOCIAL

Ky program mbështet nëpërmjet pagesave në cash dhe shërbimeve sociale, familjet në nevojë dhe individët me aftësi të kufizuara, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, zhvillimin e aftësive dhe mundësive personale, për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara social ekonomike dhe zbatohet nga Ministria e Shëndetësisë.

Zbatimi faktik i këtij programi ishte 18.4 miliardë lekë (150 milionë Euro) për 8 mujorin 2021, me një tkurrje të lehtë prej 1.2% në raport me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Dy vitet e fundit ky fond është rritur ndjeshëm (17% më i lartë se në 2019-n), si rrjedhojë e shtimit të paketave të ndihmës për përballimin e pasojave që solli COVID-19 në ekonomi dhe buxhetin e familjeve.

**Tabela 7: Zbatimi i programit të "Përkujdesit Social", sipas zërave, 8 mujori (mln lekë)**

Zbatimi i programit të Përkujdesit Social, sipas zërave, 8 mujori (mln lekë)	2019	2020	2021	Ndryshimi në %, 2021/2020
Familje dhe individë në nevojë që përfitojnë nga skema e NE <sup>21</sup>	2,683	3,713	4,571	23.1
Persona me aftësi të kufizuara dhe kujdestarë që përfitojnë pagesa	10,955	12,510	11,022	-11.9

<sup>21</sup> Ndhima ekonomike

Përfitues të shërbimeve të përkujdesit social të ofruara në qendrat rezidenciale publike	575	545	289	-47.1
Bonusi i Bebeve	1,430	1,770	2,200	24.3
Raporte monitorimi për mbrojtjen e fëmijeve	7	6	6	-2.5
Shërbime të reja sociale për grupet në nevojë të ofruara nëpërmjet njësisve vendore nga financimi i fondit social	0	51	73	43.5
Personel jo mjekësor i trajtuar me bonus për COVID-19	0	13	0	-
Fëmijë që përfitojnë shërbime në institucionet e përkujdesit	0	0	143	-
Të moshuar të trajtuar me shërbime të përkujdesit	0	0	96	-
Modernizimi i asistencës sociale	66	11	0	-
Ndërtime/rikonstruksione	27	2	0	-
<b>TOTALI</b>	<b>15,743</b>	<b>18,621</b>	<b>18,400</b>	<b>-1.2</b>
<i>Burimi: Raportet e monitorimit, Ministria e Shëndetësisë, 8 maji, 2019-2021</i>				

## VII. REHABILITIMI I TË PËRNDJEKURVE POLITIKE

Ky program synon integrimin e ish të Përndjekurve Politike nga regjimi komunist në jetën e shoqërisë shqiptare. Pagesat e dëmshpërblimit të ish dënuarve politik, për 8 majin 2021, zbatimi faktik ishte 488 milionë lekë (4 milionë Euro), me rënie 31.2% me bazë vjetore. Rënia e shpenzimeve për këtë fond, është e lidhur kryesisht me mangësitë në dokumentacion që kanë personat që duhet të përfitojnë nga ky fond, sipas burimeve nga MSHMS dhe Ministria e Financave. Burime nga Ministria e Financave thanë se trashëgimtarët e kanë të vështirë të plotësojnë dokumentacionin për të përfituar. Ndërsa vuajtësit e drejtpërdrejtë të dënimit ose kanë përfituar ose nuk jetojnë më.<sup>22</sup>

**Tabela 8: Zbatimi i programit të rehabilitimit të ish të përndjekurve politikë, sipas zërave, 8 maji (mln lekë)**

Zbatimi i programit të rehabilitimit të ish të përndjekurve politikë, sipas zërave, 8 maji (mln lekë)	2019	2020	2021	Ndryshimi në %, 2021/2020
Ish të përndjekur të rehabilituar dhe integruar	19	19	21	11.8

<sup>22</sup> Burimi: Ministria e Financave

Ish të përndjekur (dosje) të kompensuar financiarisht	958	690	467	-32.3
Pajisje	-	1	-	-
TOTALI	977	710	488	-31.2
<i>Burimi: Raportet e monitorimit, Ministria e Shëndetësisë, 8 mujori, 2019-2021</i>				

#### 4. Zbatimi i programeve, sipas zërave 4 mujori i dytë 2021


Për 4 mujorin e dytë 2021 (periudhën maj- gusht), shpenzimet totale faktike për shëndetësinë<sup>23</sup> ishin 25 miliardë lekë (203 milionë Euro), me një rritje prej 16% me bazë vjetore, ose 3.5 miliardë lekë (28 milionë Euro) më shumë.

Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2019, shpenzimet totale faktike për shëndetësinë u rritën me 20.5%.

Ndryshe nga viti 2020, kur rritja u udhëhoq nga shtimi i shpenzimeve të programeve për “përkujdesin social” dhe planifikim, menaxhim administrim, përgjatë 4 mujorit të dytë 2021-it, ashtu si në 4 mujorin e parë, zgjerimi është orientuar nga programet “Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor” dhe “Shërbime të Shëndetit Publik”, që u shtuan përkatësisht me 1.9 miliardë lekë (15.5 milionë Euro) dhe 1.5 miliardë lekë (12.3 milionë Euro).

<sup>23</sup> <https://shendetesia.gov.al/tabelat-e-raportimit-per-intervalet-kohore-3-muaj-9-muaj-dhe-vjetore-si-dhe-relacionet-perkatese/>

**Grafiku 12: Zbatimi i buxhetit të Ministrisë së Shëndetësisë sipas programeve, 4 mujori II, periudha 2019-2021**




*Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale*

Ashtu si në 4 mujorin e parë 2021, edhe në 4 mujorin e dytë, “Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor” zunë pjesën më të madhe të shpenzimeve të shëndetësisë, me

39% të totalit, ndryshe nga viti i mëparshëm, kur peshën më të lartë e mbajtën “shpenzimet e përkujdesit social”. Në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë, programi “Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor” ka një rritje me 3 pikë përqindje, e ndikuar nga shtimi i shpenzimeve për trajtimin e pacientëve në spitale. Programi i dytë është “Përkujdesi Social”, me 38% të totalit, i ndjekur nga programi “Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor” (11%).


Në dy grafikët më poshtë jepet krahasimi i peshës që zënë programet përkatëse në totalin e shpenzimeve buxhetore të MSHMS-së për periudhën e 8 mujorit për vitet 2020 dhe 2021.

**Grafiku 13: Zbatimi i buxhetit të shëndetësisë, 4 mujori II, 2020**



*Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale*

Grafiku 14: Zbatimi i buxhetit të shëndetësisë, 4 mujori II, 2021



*Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale*

Duke përjashtuar dy programet, përkatësisht “Përkujdesin Social” dhe “Rehabilitimin e të përndjekurve politike”, që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me shërbimet shëndetësore, buxheti i shëndetësisë për 4 mujorin e dytë ishte 15.2 miliardë lekë (123 milionë Euro), duke u rritur me 24.5% në krahasim me të njëjtën periudhë të 2020-s dhe 3.1.3% në krahasim me 4 mujorin e dytë 2019.


Sipas zërave kryesorë të detajuar nga pesë programet direkte të shëndetësisë, “Planifikim Menaxhim Administrim”, “Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor”, “Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor”, “Shërbime të Shëndetit Publik” dhe “Shërbimi Kombëtar i Urgjencës Mjekësore” rritja e shpenzimeve të shëndetësisë në 4 mujorin e dytë 2021 është ndikuar nga:

- “Trajtimi i pacientëve të shtruar në spitale”, fondi për të cilin u rrit me 22.2%, ose 1.1 miliardë lekë (9.3 milionë Euro) më shumë. Në krahasim me 4 mujorin e

parë, ritmet e rritjes janë ngadalësuar, duke reflektuar dhe lehtësimin e pandemisë në këtë periudhë, në raport me muajt e parë të vitit.

- “Persona të vaksinuar me vaksinën anti-COVID-19”, është një zë i ri që u zbatua për herë të parë në vitin 2021, në kuadër të programit për vaksinimin kundër COVID-19, me një fond total për 4 mujorin e dytë prej 1.4 miliardë lekë (11.2 milionë Euro), dhe është pothuajse në të njëjtat nivele me 4 mujorin e parë të vitit.
- “Pacientë të trajtuar me dializë”, fondi për të cilën u rrit ndjeshëm me 71% në 4 mujorin e dytë në raport me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ose 720 milionë lekë (5.8 milionë Euro) më shumë, në një tregues indirekt se pandemia e COVID-19 po ndikon në rritjen e barrës së sëmundjeve të tjera.
- “Numri i vizitave në Kujdesin Shëndetësor Parësor”, me një rritje prej 68% për 4 mujorin e dytë, në krahasim me maj-gusht 2020, ose 295 milionë lekë (2.4 milionë Euro) më shumë. Edhe për këtë zë, ritmet e rritjes janë ngadalësuar në krahasim me katër mujorin e parë, kur kulmoi vala e pandemisë.
- “Pacientë të trajtuar nga paketat e kardiologjisë dhe kardiokirurgjisë”, me një rritje prej 40% me bazë vjetore për 4 mujorin e dytë, ose 177 milionë lekë (1.4 milionë Euro) më shumë, edhe ky një tregues indirekt se pandemia po shkakton rritjen e barrës së sëmundjeve të tjera.

**Grafiku 15: Zbatimi i buxhetit të Ministrisë së Shëndetësisë sipas zërave kryesorë 4 mujori II, periudha 2019-2021**



*Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale*


## 5. Vdekshmëria shtesë për 9 mujorin

Në vitin e dytë të pandemisë, vdekshmëria shtesë<sup>24</sup> në vend vijoi të ishte e lartë, sidomos në tremujorin e parë të 2021-it, që përkon me valën e dytë të fortë të pandemisë, pas asaj të tetor-dhjetor 2020.

Për periudhën janar-shtator 2021, në vend u regjistruan 21,471 vdekje<sup>25</sup> me një rritje prej 17.9% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2020, kur vendi u përball me valën e parë të pandemisë.

Në raport me mesataren 2016-2019, periudhë që merret si referencë për krahasimin e vdekshmërisë shtesë të shkaktuar nga pandemia, rritja arrin në rreth 34%.

**Grafiku 16: Vdekjet, 9 mujori (nr.)- periudha 2011-2021**



*Burimi: INSTAT*

Sipas tremujorëve, rritja e vdekshmërisë shtesë për 9 mujorin erdhi si rrjedhojë e fataliteteve të larta që u shënuan në tremujorin e parë të vitit, kur u raportuan 9,657 humbje jete gjithsej, me një rritje prej 52.4% në raport me mesataren e 2016-2019 për të njëjtën periudhë. Në tremujorin e mëparshëm, tetor-dhjetor 2020, që përkon me valën e parë të fortë të pandemisë, ishin regjistruar 9,397 humbje jete gjithsej, me rritje 70%


<sup>24</sup> Vdekshmëria shtesë (excess death/mortality) është një term i përdorur në epidemiologji dhe shëndetin publik që i referohet numrit të vdekjeve nga të gjitha shkaqet gjatë një periudhe krize që është mbi dhe përtej asaj që do të pritej në kushte normale <https://ourworldindata.org/excess-mortality-COVID>

<sup>25</sup> <http://instat.gov.al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/lindjet-vdekjet-dhe-martesat/publikimet/2021/treguesit-demografik%C3%AB-t3-2021/>

në krahasim me mesataren e të njëjtës periudhë 2016-2019. Pas marsit 2021, vala e pandemisë filloi të lehtësohej, por numri i vdekjeve vijoi të mbetej më i lartë në krahasim me mesataren e para pandemisë, përkatësisht +14.4% në tremujorin e dytë 2021 dhe +22.2% në tremujorin e tretë 2021.

Gjithsesi, në një sinjal se pandemia e ka kaluar valën kulmore, në tremujorin e tretë 2021, vdekshmëria shtesë ishte 11.8% më e ulët se në të njëjtën periudhë të vitit 2020.

**Grafiku 17: Vdekjet sipas tremujorëve (nr.)**



*Burimi: INSTAT*


Edhe përgjatë 9 mujorit të vitit 2021, Shqipëria vijoi të ishte një nga vendet me rritjen më të lartë të vdekshmërisë shtesë në Europë. Shqipëria kishte rritjen e tretë më të lartë të vdekjeve në Europë për periudhën janar-shtator 2021, me 34.4%, në krahasim me mesataren e të njëjtës periudhë 2018-2019, kur nuk kishte filluar ende pandemia, pas Kosovës (+78.1%) dhe Maqedonisë së Veriut (45.2%), sipas të dhënave të Eurostat<sup>26</sup> dhe raporteve statistikore të Maqedonisë së Veriut<sup>27</sup> dhe Kosovës<sup>28</sup>. Në shtetet që vijuan marrjen e masave kufizuese edhe përgjatë periudhës përkatëse 2021 dhe e vaksinuan më shpejt popullsinë, rritja e vdekshmërisë shtesë për periudhën në fjalë nuk ishte më shumë se 10%, si p.sh në Portugali, Itali, Spanjë, Francë, Austri, Gjermani etj.

<sup>26</sup> [https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/demo\\_r\\_mwk\\_ts/default/table?lang=en](https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/demo_r_mwk_ts/default/table?lang=en)

<sup>27</sup> <https://www.stat.gov.mk/publikacii/2021/Bilten%2012%20ANG.pdf>

<sup>28</sup> <https://ask.rks-gov.net/media/6485/buletini-tremujor-tm3-2021-tetori.pdf>

**Grafiku 18: Rritja e vdekshmërisë, janar-shtator 2021 kundrejt mesatares së janar-shtator 2018-2019 (%)**



*Burimi: Eurostat, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Zyra Statistikore e Maqedonisë së Veriut, përpunime të Autorëve.*

Në vitin 2020, Shqipëria shënoi vdekshmërinë më të lartë shtesë në Europë, në krahasim me mesataren e 2016-2019, me rreth 27% (shiko raportin e Monitorimit për vitin 2020<sup>29</sup>).

## 6. Ecuria e procesit të vaksinimit

Ritmet e vaksinimit u përshpejtuan ndjeshëm në tremujorin e dytë dhe të tretë të 2021, ndërsa nga fillimi i muajit tetor është mundësuar edhe marrja e dozës së tretë përforcuese për personat mbi 18 vjeç.

Deri në 30 shtator 2021 ishin dhënë 1,732,549 doza të vaksinës ndaj COVID-19. Prej tyre 788,538 qytetarë i kanë kryer të dy dozat e vaksinës anti COVID-19<sup>30</sup>. Deri në 30 shtator, rreth 33% e popullsisë kishte marrë të paktën një dozë vaksine.

## 7. Ndikimi i Covid-19 në depistimin dhe trajtimin e sëmundjeve në sistemin publik spitalor


Kufizimi i ndërhyrjeve jo urgjente gjatë pandemisë, ulja e kontrolleve bazë, reduktimi i trajtimeve për të sëmurët kronikë, ulja e konsultave periodike, si dhe reduktimi i depistimeve për tumoret rrezikojnë në të ardhmen përkeqësim të gjendjes klinike dhe rritje të fataliteteve edhe pas pandemisë për personat me tumor, probleme në zemër, veshkat dhe hipertension. Këtyre u shtohen dhe pasojat që mund të ketë lënë COVID-19 në shëndetin e një pjese të personave që e kaluan virusin. Në vitin 2020, numri i personave të operuar ra me 27%, duke shënuar nivelin më të ulët që nga viti 2012, kur raportohen të dhënat<sup>31</sup>. Të dhënat për 2021 përditësohen në maj 2022.

<sup>29</sup> <https://www.togetherforlife.org.al/wp-content/uploads/2022/01/Expenditures-in-the-health-sector-for-pandemic-management.pdf>

<sup>30</sup> 1,732,549 doza të vaksinës ndaj COVID19. Prej tyre 788,538 qytetarë i kanë kryer të dy dozat e vaksinës antiCOVID.

<sup>31</sup> [http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST/START\\_\\_HE/](http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST/START__HE/)

## Grafiku 19: Numri i vizitave në qendrat shëndetësore, ambulanca dhe poliklinika



*Burimi: INSTAT*


Në kardiologji dhe kardiokirurgji, trajtimet e të sëmurëve u ulën 26%, për transplantet e veshkës 63%, për kataraktet 21% (për djathtë e syve e cila mund të hiqet vetëm me intervenim kirurgjik), depistimi i kancerit të gjirit 26% dhe ata të trajtuar me radioterapi 8%<sup>32</sup>.

Numri i vizitave në qendrat shëndetësore, ambulanca dhe poliklinika shënoi rënie të fortë për herë të parë që prej vitit 2004, duke u tkurrur me 4% në 2020-n, e ndikuar më së shumti nga tkurrja e vizitave të personave mbi 60 vjeç, të cilat u reduktuan me 15%<sup>33</sup>.

<sup>32</sup> <https://shendetesia.gov.al/tabelat-e-raportimit-per-intervalet-kohore-3-muaj-9-muaj-dhe-vjetore-si-dhe-relacionet-perkatese/>

<sup>33</sup> [http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST/START\\_\\_HE\\_\\_KSH/HE0160/table/tableViewLayout1/](http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST/START__HE__KSH/HE0160/table/tableViewLayout1/)

**Grafiku 20: Të sëmurë të operuar gjithsej (nr.)**



*Burimi: INSTAT*

Këtyre u shtohen dhe pasojat afatgjata që ka lënë COVID-19 në shëndetin e një pjese të madhe të pacientëve që e kanë kaluar virusin, sidomos problemet kardiake, të cilat mund të kenë nevojë për ndërhyrje të ardhshme si bypass-e, e stent-e coronare. Në 8-mujorin e 2021 rastet e trajtuara në kardiokirurgji janë rritur 11% në raport me të njëjtën periudhë të 2020-s, sipas të dhënave të raportit të monitorimit të Ministrisë të Shëndetësisë.

## 8. Rritja e barrës së sëmundshmërisë

Të dhëna operative nga Instituti i Shëndetit Publik tregojnë se rreth 20 mijë persona po vuajnë “COVID-in e gjatë”. Ata po vuajnë nga pasojat direkte dhe indirekte të sëmundjes, të tilla si dëmtime të mushkërive, lodhje kronike dhe dëmtim të sistemit nervor dhe çrregullime psikike. Pasoja të tilla zgjasin 4-5 muaj, por edhe më shumë pas kalimit të infeksionit dhe po cilësohen nga sistemet shëndetësore si sindromi “post-COVID”, ose “COVID i zgjatur”.

Të dhënat e deritanishme nga MSHMS tregojnë se pandemia COVID 19 pritet të rrisë barrën e të sëmurëve kronikë<sup>34</sup>.

Fibrozat në mushkëri post-COVID, përveçse janë një ngarkesë e re për sistemin, ulin në mënyrë të ndjeshme produktivitetin e jetës te personat e prekur. Përgjithësisht këta persona nuk përballojnë punë të rënda fizike dhe kanë nevojë për mjekime që zgjasin gjithë jetën, duke u shndërruar në barrë për shoqërinë dhe sistemin shëndetësor në afat të gjatë.

Për periudhën janar-gusht 2021 në spitalet psikiatrike numri i pacientëve të shtruar është rritur 10,5% në krahasim me vitin e kaluar

Trajtimi i çrregullimeve të shëndetit mendor është një sfidë globale e shëndetit publik, e cila sa vjen e po merr përmasa më të mëdha. Këto çrregullime nga të dhënat statistikore rezultojnë se prekin më shumë pjesë të shoqërisë me status të ulët socio-ekonomik. Familjet me të ardhura të ulëta kanë barrën më të lartë të sëmundjeve të shëndetit mendor. Çrregullimet e shëndetit mendor shoqërohen me vonesa në kërkimin e ndihmës mjekësore, vonesa në të kuptuarit e problemit dhe ulje të aksesit në shërbimet shëndetësore. Gjithashtu, diagnostikimi është më i vështirë për individët që kanë sëmundje të tjera kronike ose akute dhe shfaqin probleme të shëndetit mendor<sup>35</sup>.

## 9. Rishikimi i buxhetit të shëndetësisë

Qeveria e Shqipërisë me Aktin Normativ të datës 22 qershor 2021 ndryshoi buxhetin 2021, në mënyrë që të rriste fondet për sektorin e shëndetësisë, kryesisht për blerjen e vaksinave<sup>36</sup>.

Por tabelat e detajuara, sipas programeve dhe funksioneve kryesore që shoqëronin ndryshimet në buxhet treguan se fondet totale për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale u shkurtuan me rreth 8 milionë Euro. Me Aktin Normativ të qershorit 2021 fondet totale për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale arritën në 70.4 miliardë lekë (572 milionë Euro) nga 71.4 miliardë lekë (580 milionë Euro) që ishin në buxhetin fillestar.

Akti Normativ i qershorit 2021 rriti defiçitin buxhetor në nivelin 120,5 miliardë lekë (rreth 1 mld Euro) nga 108 miliardë lekë që ishte planifikuar në fillim të vitit. Qeveria e rriti masën vjetore të defiçitit, e për rrjedhojë borxhin duke shkelur rregullin fiskal të

<sup>34</sup> <https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/434>.

<sup>35</sup> <https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/434>.

<sup>36</sup> <http://www.parlament.al/ProjektLigje/ProjektLigjeDetails/54618>.

përcaktuar në Ligjin Organik të Buxhetit në vitin 2016, i cili përcakton se çdo vit borxhi publik vjen në ulje deri sa të arrijë poshtë kufirit 45% e PBB<sup>37</sup>.

Përfshirja e rregullit fiskal “borxh me ulje vit pas viti” në Ligjin e Menaxhimit Buxhetor pesë vite më parë, plotësoi standardin e kërkuar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Bashkimi Europian. Duke respektuar këtë normë, sipas planifikimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në kuadrin makroekonomik 2017, borxhi publik i vendit do të zbriste poshtë nivelit 60% në vitin 2020, për t’u ulur drejt normës së synuar 45% të PBB në vitin 2024. Lehtësimi nga barra e borxhit do t’i relaksonte qeveritë shqiptare nga efektet negative të krizave të papritura dhe nga ana tjetër, do të krijonte mundësitë për të realizuar investime të qëndrueshme pa çënuar stabilitetin fiskal.

## 10. Ndhmat e huaja për pandeminë

Nga marsi i vitit 2020 deri në qershor të vitit 2021, ndihmat dhe donacionet e huaja të dhëna për përballimin e krizës shëndetësore të shkaktuar nga COVID-19 arritën në 1 miliardë lekë (8.1 milionë Euro), nga të cilat, 671 milionë lekë (5.4 milionë Euro) ishin në formën e pajisjeve për spitalet, 191 milionë lekë ishin mjete mbrojtëse për ekipet mjekësore dhe 216 milionë lekë (1.7 milionë Euro) ishin kite dhe reagente për laboratorët publike që i shërbyen rritjes së testimeve ndaj të dyshuarve si të infektuar.

Siç shihet nga tabela e mëposhtme donatori më i madh ishin Kombet e Bashkuara nëpërmjet programet UNOPS e PNUD me mbi 500 milionë lekë (4 milionë Euro) ose 50 për qind e totalit të ndihmës së huaj, pjesa më e madhe e së cilës u dha për pajisje, kite dhe reagente. Mes donatorëve renditet edhe kompania e emirateve të Bashkuara Arabe EMAAR me 45 milionë lekë (365 mije Euro), të cilat u dhanë në formën e mjeteve mbrojtëse për stafet mjekësore. Kujtojmë se kompania EMAAR ka marrë ekluzivitetin nga qeveria shqiptare për të ndërtuar një port jahtesh dhe një kompleks banesash luksoze në vendin ku sot ushtron aktivitetin Porti i Durrësit. Ndihma e huaj e dhënë për menaxhimin e emergjencës shëndetësore është sa 10% e fondeve që u vunë në dispozicion për përballimin e emergjencës shëndetësore nga qeveria nga marsi 2020 në qershor 2021.

---

<sup>37</sup> <https://www.financa.gov.al/ligjet/>

**Tabela 9: Donacionet e huaja për pandeminë në Lekë/EUR**

Viti	Donatori	Vlera në lekë	Vlera në Euro
2020	Ambasada Amerikane	6,823,000	55,472
2020	Emiratet e Bashkuara Arabe	9,201,562	74,809
2020	EMAAR	45,680,618	371,387
2020	Katar	54,825,284	445,734
2020	PNUD	80,287,427	652,743
2020	UNOPS	432,421,009	3,515,618
2020	Jordania	53,272,518	433,110
2020	Arabia Saudite	33,221,671	270,095
2021	Ambasada Gjermane	21,656,800	176,072
2021	NATO	111,213,000	904,171
2021	UNOPS	230,467,958	1,873,723
	<b>TOTALI</b>	<b>1,079,070,847</b>	<b>8,772,934</b>
Burimi: Ministria e Shëndetësisë			

## 11. Konkluzione

Ndonëse shpenzimet për shëndetësinë kanë shënuar një rritje të ndjeshëm në 8 mujin 2021, kjo rritje ishte e detyruar nga situata emergjente për shkak të nevojës për të vaksinuar popullatën dhe përbalimin e shpenzimeve për trajtimin e të shtruarve në spitale.

Buxheti i shtetit vijon të mos i japë vëmendjen e duhur shpenzimeve në shëndetësi. Pavarësisht se qeveria ka deklaruar se rriti borxhin publik në rreth 80% të PBB-së në 2021 për t'i dhënë mbështetje sektorit të shëndetësisë, në realitet i ka shkurtuar fondet për shëndetësinë. Në ndryshimet e fundit buxhetore që u bënë me akt normativ në 3 dhjetor 2021, tregojnë se fondet totale për Ministrinë e Shëndetësisë ishin 70,1 miliardë lekë, 0.6 % më të ulta se në buxhetin fillestar.

Pasojat direkte të pandemisë në shëndetin e personave që e kanë kaluar atë, si dhe vonesat në trajtimin e diagnostikimit të sëmundjeve të tjera për shkak të karantinës, kanë ndikuar në rritjen e barrës së sëmundshmërisë në vend për 9 mujin 2021.

Sistemi shëndetësor do të vuajë pasojat e “COVID të zgjatur” çka do të ndikojë në rritjen e barrës së të sëmurëve kronike në vijim.

Shqipëria mbetet ndër të fundit në Evropë sa i përket vaksinimit përgjatë gjithë vitit 2021, në raport me popullatën, pavarësisht angazhimit të qeverisë me sigurimin e 2.6 milionë dozave të vaksinave dhe vendimit për dhënien e dozës së tretë. Shqipëria mbetet ndër vendet me skepticizëm të lartë ndaj përdorimit të vaksinave. Ky skepticizëm mund të jetë i lidhur edhe me efikasitetin e ulët të vaksinave kineze<sup>38</sup>, me të cilat është vaksinuar pjesa më e madhe e popullsisë.

Spektori i shëndetit në Shqipëri vuan nga mungesa e të dhënave. Mungojnë raportimet, transparenca dhe digjitalizimi i tyre. Mungesa e të dhënave bëhet shkak për politika të dobëta dhe nuk i çon investimet në infrastrukturë dhe burimet njerëzore aty ku duhet.

---

<sup>38</sup> <https://www.ft.com/content/c57028b4-573e-4ca4-8266-4d7c0ab72492>

## 12. Rekomandime

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të përqendrojë burimet dhe përpjekjet për të ofruar kujdes më të mirë shëndetësor me kosto të përgjithshme më të ulët dhe të jetë e përgatitur për valët e ardhshme të COVID-19 - apo edhe pandemi të tjera të mundshme.

Pandemia dhe shtimi i barrës së sëmundshmërisë në vend po rrit nevojën për më shumë shpenzime në kujdesin shëndetësor e për rrjedhojë edhe për një fokus më të qartë të orientimit të fondeve publike.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale duhet të ofrojë burime shtesë financimi, më shumë burime njerëzore dhe të shtrojë nevojën për të rritur digjitalizimin në mjekësi në mënyrë që të mund të lehtësohet ofrimi i shërbimeve shëndetësore për të sëmurët dhe për të eliminuar radhën në qendrat shëndetësore.

Shpenzimet për shëndetësinë në raport me PBB-në, që historikisht janë luhatur në rreth 3 për qind të PBB-së, duhet të rriten gradualisht të paktën me 2 pikë përqindje, duke arritur në

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe institucionet e varësisë, në bashkëpunim edhe me aktorë të shoqërisë civile duhet të bëjnë më shumë për të edukuar popullatën për efikasitetin e vaksinimit, duke promovuar përdorimin e vaksinave të tjera përveç atyre kineze.

## Referenca

- Raportet e Monitorimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, 8 mujori 2019-2021 dhe 4 mujori i parë 2019-2021
  - <https://shendetesia.gov.al/tabelat-e-raportimit-per-intervalet-kohore-3-muaj-9-muaj-dhe-vjetore-si-dhe-relacionet-perkatese/>
- Të dhëna për vdekshmërinë shtesë
  - <http://instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/lindjet-vdekjet-dhe-martesat/publikimet/2021/treguesit-demografik%C3%AB-t3-2021/>
  - <https://ourworldindata.org/excess-mortality-covid>
  - [https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/demo\\_r\\_mwk\\_ts/default/table?lang=en](https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/demo_r_mwk_ts/default/table?lang=en)
- Tregues të shëndetësisë
  - [http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST/START\\_HE/](http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST/START_HE/)
  - [http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST/START\\_HE\\_KSH/HE0160/table/tableViewLayout1](http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST/START_HE_KSH/HE0160/table/tableViewLayout1)
- Raportet e Fondit Monetar Ndërkombëtar për Shqipërinë
  - <https://www.imf.org/en/News/Articles/2021/10/12/mcs101221-albania-2021-article-iv-consultation-concluding-statement>
- Treguesit fiskalë të konsoliduar të buxhetit të shtetit:
  - <http://financa.gov.al/statistika-fiskale-mujore/>
  - <https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/434>
  - <http://www.parlament.al/ProjektLigje/ProjektLigjeDetails/54618>

**Fondacioni Westminster për Demokraci (WFD) është organ publik i Mbretërisë së Bashkuar i dedikuar për të mbështetur demokracinë në mbarë botën. Duke vepruar ndërkombëtarisht, WFD punon me parlamentet, partitë politike dhe grupet e shoqërisë civile, si dhe me zgjedhjet për të ndihmuar shtetet të kenë sisteme politike më të drejta, më gjithëpërfshirëse dhe të përgjegjshme.**



**[www.wfd.org](http://www.wfd.org)**



**@WFD\_Democracy**



**@WestminsterFoundation**



Fondacioni Westminster për Demokraci  
është një organ ekzekutiv publik i sponsorizuar  
nga Ministria e Punëve të Jashtme,  
Komonuelthit dhe Zhvillimit.

